

P. nr.91/18

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. P. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.2 te KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP.nr.1314//17 të datës 02.02.2018 në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **13.04.2018**, në prani të Prokurorit te shtetit Bajram Kryeziu dhe te akuzuarit A. P., te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **A. P.** nga Gjakova „Rr”....” p.n, data e lindjes . . . ne Gjakovë ,i biri i H. dhe i nënës R. e gjinisë M, ka te kryer shkollën fillore ,i pa punët , i gjendjes se dobët ekonomike shqiptar , shtetas i R. Kosovës , i pa martuar, me nr. ID .....

**Ë s h t ë f a j t o r :****Sepse:**

**-me dt. 29.07.2017**,rreth orës 18.30 min, në Gjakovë , ne Rr.”....” , me qëllim përvetësimi të kundërligjshëm për veti apo për tjetrin , i merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit L. A. Q. nga Gjakova Rr”.....”, në atë mënyrë që shkon te pallati i Sporteve “.....”, në Gjakovë, dhe e vjedh biçikletën ngjyrë hiri e me te largohet nga aty , e pas një defekti biçikletën e dërgon në riparim te dyqani “.....” në Gjakovë, e pas riparimit meqë nuk kishte mjete pagese , biçikletën ia shet 15.€ pronarit dyqanit , e biçikleta nga i dëmtuari rastësisht gjendet në lokal , ku sekuestrohet e i kthehet të dëmtuarit.

**-me çka ka kryer vepër penale vjedhje nga neni 325 par. 2 te KPRK-së**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës, dhe nenit 325/2 te KPRK-së dhe nenit 365 te KPPK-së, te akuzuarit A. P. i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve** i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari L. Q. ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet gjyqësore dhe atë në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30.00 €. në afat prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1314//17 të datës 02.02.2018 , e ka akuzuar të akuzuarin A. P. nga Gjakova , për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325/2 të KPRK-së,

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 13.09.2018, përfaqësuesi i PTH-së në Gjakovë , Prokurori Bajram Kryeziu , pasi lexon aktakuzën PP.nr.1314//17 të datës 02.02.2018, deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës por duke marr parasysh vlerën e demit gjegjësisht biçikletës është sipas te dëmtuarit me vlerë

prej 40 euro ,athëte bazuar ne dispozitat ligjore beje rikualifikimin e veprës penale nga neni 325/1 ne nenin 325/2 te KPRK-ës , pjesa tjetër mbete e pandryshuar . se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari A. P. , në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tersi fajësinë sipas aktakuzës së ri kualifikuar me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion , shtojë se është i penduar për veprën e kryer, e për te cilën nuk ka ditur se është duke kryer vepër penale te vjedhjes me qene seSe biçikleta nuk ka qene e mbyllur dhe e njëjta ka qene e vjetër dhe te njëjtën e kam blerë nga një person te cilën nuk e njohë ,kërkojë falje nga pala e dëmtuar për demin e shkaktuar edhe pse te njëjtit biçikleta i është kthyer ,andaj i propozoi gjykatës qe te merr para gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike , premtimi se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

-Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari A. P. : **me dt. 29.07.2017**,rreth orës 18.30 min, në Gjakovë , në Rr.”...” , me qëllim përvetësimi të kundërligjshëm për veti apo për tjetrin , i merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit L. A. Q. nga Gjakova Rr”....”, në atë mënyrë që shkon te Pallati i Sporteve “....” në Gjakovë, e vjedh biçikletën ngjyrë hiri e me te largohet nga aty , e pas një defekti biçikletën e dërgon në riparim te dyqani “....” në Gjakovë, e pas riparimit meqë nuk kishte mjete pagese , biçikletën ia shet 15.€ pronarit dyqanit , e biçikleta nga i dëmtuari rastësisht gjendet në lokal , ku sekuestrohet e i kthehet të dëmtuarit.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, gjendjen e dobët ekonomike , pendimin e tij , sjelljen korrekte në gjykim , kërkim falja nga i dëmtuari për demin që i është shkaktuar , premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla , si dhe fakti i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **3(tre)**muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** ) nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale , do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike u muarr konform nenit 463 te KPPK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.91/18 më datë 13.09.2018**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.